



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 242/_ Prot.

Tiranë, më 17/06/2016

V E N D I M

Nr.64, Datë 17/06/2016

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË BASHKINË LUSHNJE, "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

V E N D O S A:

I. "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Lushnje, për periudhën 01.07.2014 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm rezultoi se veprimtaria e administratës së bashkisë nuk mbështetet në strategji zhvillimi afat mesme dhe vjetore si dhe nuk ka programuar dhe miratuar objektiva strategjik por i kryen aktivitetet me plane pune periodike për realizimin e misionit të ngarkuar me ligjin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Në këto kushte edhe vlerësimi dhe menaxhimi i riskut në mungesë të objektivave kryhet i pjesshëm dhe në shumë raste formal sa për të plotësuar kërkesat e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, funksionimi i administratës së bashkisë, përfshi 10 ish-komuna në strukturë si Njësi Administrative të Bashkisë, mbështetet ende në rregulloren ekzistuese si dhe, në të gjithë administratën, nuk ka gjetur zbatim ligji për statusin e nëpunësit civil.

1.1.Rekomandim: Bashkia Lushnjë të ngrejë një grup pune me drejtues dhe specialistë, me një program të mirë përcaktuar pune, për vlerësimin e situatës aktuale, përfshi dhe njësitë

administrative, dhe të përgatisin mbi bazën e konkluzioneve, strategjinë afatmesme dhe atë vjetore të bashkisë me qëllim përcaktimin sa më real të objektivave që duhet të arrijë Bashkia Lushnjë si dhe planet periodike të veprimit për përmbushjen e objektivave si dhe përshtatjen e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të bashkisë për të përfshirë në përcaktimet e saj veprimtarinë e njësive administrative dhe masat disiplinore dhe administrative që duhen parashikuar për punonjësit në raste të shkeljeve apo mos përmbushjes së detyrave të ngarkuara. Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për implementimin e ligjit për statusin e nëpunësit civil në administratën e Bashkisë, Lushnjë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me regjistrat e protokollit për vitin 2015, në total 6 regjistra, rezultoi se shumë akte janë regjistruar pa datë dhe pa plotësuar rubrikat përkatëse sipas modularit të librit të protokollit, ka vende bosh midis rreshtave të regjistrimit të korrespondencës e cila krijon mundësinë për regjistrime të mëvonshme dhe manipulime në librin e protokollit, nuk ka numër rendor të faqeve të librave të protokollit të vulosura me vulën e institucionit e cila lë hapur mundësinë e ndryshimit të tyre në të ardhmen. Përveç sa më sipër, audit i brendshëm ka vepruar pjesërisht formalisht në përgatitjen e planeve të angazhimeve të auditimit, duke u përqendruar çdo vit në të njëjtin sektor.

2.2.Rekomandim: Sektori i Auditit të Brendshëm Publik, të rishikojë planin vjetor të auditimit për vitin 2016 dhe në bazë të kapaciteteve që disponon për periudhën 2014-2015 të parashikojë për auditim edhe ish-komunat, si dhe sektorë të rëndësishëm në administratën e bashkisë respektivisht: aktiviteti-ekonomiko-financiar, sektori i burimeve njerëzore, sektori i protokoll-arkivit për dorëzimin e dokumentacionit të ish-Komunave, me qëllim marrjen e masave sa më shpejt të jetë e mundur për vendosjen në efikasitet të sistemeve të menaxhimit, drejtimit e kontrollit, për sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, rregullave të brendshme të funksionimit dhe kontributit specifik në arritjen e objektivave strategjike të institucionit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me masat e rekomanduara nga KLSH në auditimin e fundit, dërguar me shkresë nr. 771/7, datë 15.12.2014 rezultoi se nuk janë vlerësuar e marrë masat e nevojshme për zbatimin e masave për shpërblim dëmi dhe ato disiplinore si dhe nga masat organizative të rekomanduara janë zbatuar vetëm 3 nga 9 të tilla. Për zbatimin e tyre, Titullari i Institucionit ka dhënë Urdhrin nr. 232, datë 23.12.2014 i cili në pjesën më të madhe nuk është zbatuar, ka gjetur zbatim vetëm për tre masa organizative.

3.1Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, të marrë në analizë situatën e zbatimit të Urdhrit nr. 232, datë 23.12.2014, “Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm”, të dalin përgjegjësitë individuale dhe ato institucionale për mos vlerësimin dhe zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH dhe të hartohet plan-veprimi specifik për vlerësimin sipas afateve administrative dhe zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH me shkresë nr. 771/7, datë 15.12.2014.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Urdhër shpenzimet nuk ishin të shoqëruara me dokumentacionin e plotë të justifikimit të shpenzimit, pasi sipas argumentimit të zyrës së financës gjatë ballafaqimit, për të mos rënduar dokumentacionin, dokumentet justifikuese të shpenzimit administroheshin më vete. Gjithashtu u konstatuan likuidime me shumë vonesë të faturave të prapambetura, mallrat sidomos të blera me procedurë me vlerë të vogël, bëheshin hyrje në magazinë pa procesverbal të komisionit të marrjes në dorëzim si dhe gjatë inventarizimit të pasurisë së institucionit nuk evidentohen mallrat që kanë vlerë përdorimi nga përbërja si dru, metal etj. pavarësisht se janë nxjerrë jashtë përdorimit.

4.1Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa për të forcuar kontrollin financiar në drejtim të shpenzimeve dhe administrimit material, duke përcaktuar dhe monitoruar në vazhdimësi aktivitetet e çdo hallke të funksionimit e financave të bashkisë sipas përcaktimeve në Udhëzimin e Ministrit Financave nr. 30, datë 27.12.2011 të MF “Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procedurat e prokurimit, të realizuara nga bashkia dhe njësitë vartëse kryesisht për mallra dhe ushqime të normuara me bazë numrin e fëmijëve në kopshte, çerdhe e konvikte, rezultoi se përlllogaritja e fondit limit mbështetëj në evidencë të pakonfirmuar dhe jashtë realitetit dhe bashkëpunimit institucional me hallkat kompetente në administratën e bashkisë. Preventivat respektive nuk argumentonin nevojat sipas normave të kalorive që duhet të përfitojnë fëmijët si dhe nuk ishte në nivelin e duhur bashkëpunimi dhe kontrolli reciprok midis njësive furnizuese dhe atyre shpenzuese për ushqimin dhe akomodimin e fëmijëve në kopshte, çerdhe dhe konvikte.

5.1 Rekomandim: Nga Administrata e Ndërmarrjes Pasurisë Publike dhe ajo e Kopsht- Çerdhe-Konvikteve, të hartohet një program masash për sigurimin e nivelit të duhur të menaxhimit e më andej të administrimit material, me qëllim plotësimin e nevojave të fëmijëve sipas normave të caktuara dhe standardeve përsa i përket kalorive për ushqimet nëpërmjet programimit të preventivave reale për efekt të përlllogaritjes së fondit limit mbështetur në regjistra të protokolluar dhe inventarizuar, sidomos përsa i përket fëmijëve të regjistruar dhe përfitues të shërbimeve si dhe të instalojë bashkëpunimin dhe rakordimin periodik midis njësive administruese dhe atyre shpenzuese.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procedurat e prokurimit u konstatua se në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, kryesisht për prokurimet e fondeve për punë publike, ka mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomike nuk të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderëve. Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të qartë nga ana e Njesisë së Prokurimit, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave t’i interpretojë ato në mënyra të ndryshme e subjektive madje me impakt financiar në dëm të autoritetit kontraktor.

6.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht atyre institucionale në vendimarrje për përcaktimin e njësisë së prokurimit, duke përfshirë përveç anëtarëve me formim juridik, anëtarë me formim ekonomik e financiar si dhe, në pamundësi objektive, të angazhojë ekspertë të këtyre fushave, me qëllim përcaktimin e kriterëve të veçanta dhe specifikimeve teknike në prokurimin e fondeve për punë publike, sa më reale, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, për të garantuar realizimin e kontratave me cilësi duke siguruar në të njëjtën kohë përdorimin me efektivitet dhe dobishmëri të fondeve publike dhe duke shmangur sa më shumë subjektivizmin në vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Të kërkohej në mënyrë institucionale nga Njësia e Prokurimit që përpara se të propozojë për miratim DST, në rastet kur çmimi i kontratës mbështetet në preventiva të përgatitur nga ekspertë jashtë njësisë së prokurimit, të verifikojë përputhshmërinë e çmimeve të preventivit me çmimet e manualit në fuqi, të çmimeve të tregut dhe atyre me bazë analizën e çmimit, me qëllim shmangien e rritjes në mënyrë fiktive të fondit limit dhe sigurimin e mirë përdorimit të fondeve publike.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me zbatimin e kontratave për punë publike u konstatua se dosjet teknike të investimeve rezultojnë me mangësi në dokumentacion, të cilat nuk përputhen me kërkesat e Udhëzimit të KM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

7.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit. Të vendosen kontrollet respektive sipas fazave të zbatimit të kontratës, të mos tolerohet në pranimin e situacioneve dhe marrjen në dorëzim të punëve pa siguruar administrimin e plotë dhe të kërkuar të dokumentacionit teknik përkatës.

8. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga shërbimet, rezultoi se niveli i realizimit të planit, në rang institucioni është në nivele të ulëta, respektivisht 55-60%, me një rritje të lehtë prej 5% në vitin 2015, krahasuar me vitin paraardhës. U konstatua gjithashtu se shtatë zëra në taksat dhe tarifat në tërësi, kanë realizimin nën 50% të planit vjetor të miratuar. Detyrimet debitore ndaj bashkisë, më së shumti janë gjatë vitit 2015 dhe një pjesë e mirë e tyre me historik borxhi prej disa vjetësh. Peshën më të madhe të borxhit e kanë individët tek të cilët një pjesë e mirë janë jashtë kontrollit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore sa për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme aq edhe për shkak të ndryshimit nga subjektet të adresës së ushtrimit të aktivitetit, marrjes së një NIPTI tjetër, kalim në regjistrin pasiv, falimentim etj., faktorë të cilët e vështirësojnë deri në pamundësi kontaktimin dhe krijimin e mundësisë për përdorimin e masave shtrënguese për likuidimin e detyrimeve debitore. Njëkohësisht është konstatuar se subjekte të biznesit që kanë detyrime të hershme të pa likuiduara ndaj bashkisë kanë marrë në vazhdimësi shërbime, edhe gjatë vitit 2015, si leje ndërtimi, kontrata për punë dhe shërbime pa i vënë para masave shtrënguese për likuidimin e detyrimeve përpara se të përfitojnë shërbime nga Bashkia.

8.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për organizimin e një analize të mirë përparimtare të situatës për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore dhe, në bazë të konkluzioneve, të studiohen mundësitë për minimizimin e faktorëve kërcënues në drejtim të evidentimit kontabël dhe në terren të subjekteve debitore për kontaktimin e tyre, me qëllim aplikimin e metodave të parashikuara në Ligjin për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe ato të përcaktuara në paketën fiskale vendore për rritjen e nivelit të mbledhjes së të ardhurave, për projeksionin real të burimeve për efekt të planifikimit dhe instalimin e bashkëpunimit të ngushtë jo vetëm midis Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe strukturave të tjera brenda Bashkisë, të ngarkuara për taksa të caktuara, por dhe me institucione të treta të ngarkuara me ligj në rolin e agentit për mbledhjen e të ardhurave për bashkinë sipas relevancës me funksionimin e tyre. Të merren masa për rritjen e bashkëpunimit midis strukturave të bashkisë, të evidentohen subjektet debitorë të biznesit dhe të mos përfitojnë shërbime në vazhdimësi pa likuiduar detyrimet ndaj bashkisë.

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Lushnjë, përveç VKM për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, nuk administrohet asnjë dokumentacion tjetër mbi përputhshmërinë e procesit të inventarizimit dhe kalimit të pronësisë si dhe të inventarizimit të tokave bujqësore. Nga auditimi rezultoi se nuk është bërë asnjë aplikim në ZVRPP Lushnjë për regjistrimin e pronave të shumicës së ish-komunave të shkrira.

Në Bashkinë Lushnjë dhe në disa ish-komuna të shkrira, në listën përfundimtare të pronave publike, shtetërore, ekzistojnë prona të llojit truall, të zëna nga subjekte private, e përcaktuar nga komisioni gjatë inventarizimit, në rubrikën 'funksioni për të cilën përdoret prona' të cilat shfrytëzohen nga privatët jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, në forma ligjore të njohura dhe veçanërisht asaj të dhënies me qira, të cilat, referuar çmimit minimal të dhënies me qira sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014, pronat, truall i lirë, sipas trajtimit në faqet nr. 158-175 të raportit, do të gjeneronin të ardhura për bashkinë në shumën totale prej rreth **243 milion lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë për periudhën objekt i auditimit.

Në përfundim të auditimit rezultoi se Bashkia, nuk ka plotësisht nën kontroll situatën në lidhje me asetet e paluajtshme që ka në pronësi dhe në përdorim si rezultat i mos regjistrimit të të drejtave të pronësisë apo përdorimit, kryerjes jo në përputhje me përcaktimet ligjore të procesit të inventarizimit dhe marrjes së tyre në dorëzim, mos ushtrimit të kontroleve dhe saktësisht të kufijve të pronave, numrave të pasurisë sipas zonave përkatëse kadastrale, mos shfrytëzimit të tyre në formën e qiradhënies, përfshi dhe tokat bujqësore të pandara në dispozicion.

9.Rekomandim: Bashkia Lushnjë të ngrejë një grup pune të përbërë nga specialistë të fushës, ku të përfshihen dhe specialistë të ish-komunave, i cili në bazë të një strategjie sektoriale dhe

një plani masash konkrete dhe me afate të përcaktuara të analizojë situatën e aseteve dhe të fillojë menjëherë **punën për:**

1. Vazhdimin me ritme më të shpejta për përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar dhe aplikimin e njëpasnjëshëm për regjistrimin sa më shpejt të pronave që i kanë kaluar Bashkisë Lushnjë, së bashku me njësitë administrative, si dhe të verifikohet situata e pronave në bashkëpunim me ZVRPP dhe Agjencinë e ALUIZNIT për ndërtime të mundshme pa leje në pronat që i kanë kaluar bashkisë dhe që mund të jenë futur në proces legalizimi dhe, në rast se evidentohen situata të tilla, të kërkojë në rrugë ligjore rivendosjen e të drejtave të pronave në interes të bashkisë.

2. Identifikimin e gjurmës së pronave në terren, përcaktimit të kufijve dhe statusit të tyre si dhe identifikimin e tokave bujqësore të pandara në territorin nën juridiksion të bashkisë dhe njësive administrative me qëllim shfrytëzimin e këtyre burimeve në interes të bashkisë në formën e dhënies me qira.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

B.1. Masa për Shpërblim Dëmi

Nga Bashkia Lushnjë, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **10,631,933 lekë**, sipas gjetjeve në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Vlera prej **1,552,100 lekë**, nga ish-anëtarët e Këshillit Bashkiak, Lushnjë, sipas aneksit nr. 1 të raportit, për shpërblim për punë të pakryer.

1.1.Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit për shpërblim për punë të pakryer, në vlerën **1,552,100 lekë**, nga ish-anëtarët e Këshillit Bashkiak, Lushnjë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Vlera prej **654,750 lekë**, nga ish-anëtarët e Këshillit Komunes, ish-Komuna Golem, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnjë, për shpërblim për punë të pakryer.

2.2 Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit për shpërblim për punë të pakryer, në vlerën **654,750 lekë**, nga ish-anëtarët e Këshillit Bashkiak, Lushnjë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Vlera prej **97,077 lekë**, nga “**██████████**” detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 3109, datë 07.08.2014 me objekt “Godinë 6kat + Podrum (2kat shërbime+4kat banim), shtesë anësore banimi në katin e parë të godinës ekzistuese”.

3.1Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **97,077 lekë** nga “**██████████**” detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 3109, datë 07.08.2014 me objekt “Godinë 6kat + Podrum (2kat shërbime+4kat banim), shtesë anësore banimi në katin e parë të godinës ekzistuese”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Vlera prej **470,502 lekë**, nga shoqëria “**██████████**” shpk, me NIPT K64702405E, detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 3196, datë 14.08.2014 me objekt “Godinë banimi dhe shërbimi 5,7,10 kate + 1 kat nëntokë (3kt njësi shërbimi + 7kt banimi + 1kt nën tokë)”.

4.1Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **470,502 lekë** nga shoqëria **██████████** shpk, me NIPT K64702405E, detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr.

3196, datë 14.08.2014 me objekt “Godinë banimi dhe shërbimi 5,7,10 kate + 1 kat nëntokë (3kt njësi shërbimi + 7kt banimi + 1kt nën tokë)”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Vlera prej **1,790,604 lekë**, nga shoqëria “██████████” shpk, detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 174/3, datë 29.6.2015, miratuar nga ish-Komuna Golem, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnjë, me objekt “Kapanone metalike të çmontueshme për mirëmbajtjen e mjeteve bujqësore dhe magazinë për mbajtjen e prodhimeve bujqësore”.

5.1Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **1,790,604 lekë** nga shoqëria “██████████” shpk, detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 174/3, datë 29.6.2015, miratuar nga ish-Komuna Golem, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnjë, me objekt “Kapanone metalike të çmontueshme për mirëmbajtjen e mjeteve bujqësore dhe magazinë për mbajtjen e prodhimeve bujqësore”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Vlera prej **75,312 lekë**, nga shoqëria “██████████” shpk, detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 3684, datë 23.9.2014, me objekt “Qendër e re për Grumbullimin, Seleksionimin, Ruajtjen dhe Shpërndarjen e in puteve dhe Prodhimeve Bujqësore, Zyrat e Administratës dhe Depo ambalazhi”.

6.1Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **75,312 lekë** nga shoqëria “██████████” shpk, detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 3684, datë 23.9.2014, me objekt “Qendër e re për Grumbullimin, Seleksionimin, Ruajtjen dhe Shpërndarjen e in puteve dhe Prodhimeve Bujqësore, Zyrat e Administratës dhe Depo ambalazhi”.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Vlera prej **560,000 lekë**, për mos llogaritje dhe arkëtim të tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për çdo kantier ndërtimi, nga bashkimi i shoqërive “██████████” shpk & “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë; nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë; nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 210,000 lekë; nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë; nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë dhe nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë.

7.1Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **560,000 lekë** për mos llogaritje dhe arkëtim të tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për çdo kantier ndërtimi, nga bashkimi i shoqërive “██████████” shpk & “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë; nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë; nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 210,000 lekë; nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë; nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë dhe nga shoqëria “██████████” shpk, në shumën 70,000 lekë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Vlera prej **3,957,578 lekë** (pa tvsh), nga shoqëria “██████████” shpk, nga të cilat shuma prej 2,405,963 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4311 prot., datë 14.07.2015 me objekt “Rehabilitimi i Fasadave në Qendër të Qytetit dhe në Rrugën “Misto Mane”, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera dhe shuma prej 1,551,615 lekë, nga të cilat vlera prej 1,293,600 lekë për punime të pakryera të likuiduara dhe vlera prej 258,015 lekë si pasojë e dëmeve të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. - prot., datë 15.06.2015 me objekt: “Shtrimi i Rrugëve Bujqësore me Çakull dhe objektin “Rikompozim i Lulishtes Bubullimë”, ish-Komuna Bubullimë, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnje.

8.1Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **3,957,579 lekë** (pa tvsh) nga shoqëria “██████████” shpk, nga të cilat shuma prej 2,405,963 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4311 prot., datë 14.07.2015 me objekt “Rehabilitimi i Fasadave në Qendër të Qytetit dhe në Rrugën “Misto Mane”, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera dhe, shuma prej 1,551,615 lekë,

nga të cilat vlera prej 1,293,600 lekë për punime të pakryera të likuiduara dhe vlera prej 258,015 lekë si pasojë e dëmeve të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. - prot., datë 15.06.2015 me objekt: “Shtrimi i Rrugëve Bujqësore me Çakull dhe Rikompozim i Lulishtes Bubullimë”, ish-Komuna Bubullimë, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnje.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Vlera prej 537,390 lekë (pa tvsh), nga shoqëria “██████████” shpk, nga të cilat (1) shuma prej 248,400 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4015 prot., datë 19.06.2015 me objekt “Rikontruksioni i Rrugës “Vasil Bello””, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit të Auditimit; (2) shuma prej 156,750 lekë, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3822 prot., datë 09.06.2015 me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugës “Abdyl Korreshi””, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera dhe (3) shuma prej 132,240 lekë , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3840 prot., datë 11.06.2015 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës “Idriz Seferi”” Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera.

9.1 Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë 537,390 lekë (pa tvsh), nga nga shoqëria “██████████” shpk, nga të cilat (1) shuma prej 248,400 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4015 prot., datë 19.06.2015 me objekt “Rikontruksioni i Rrugës “Vasil Bello””, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera; (2) shuma prej 156,750 lekë, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3822 prot., datë 09.06.2015 me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugës “Abdyl Korreshi””, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera dhe (3) shuma prej 132,240 lekë , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3840 prot., datë 11.06.2015 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës “Idriz Seferi”” Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Vlera prej 936,620 lekë (pa tvsh), nga shoqëria “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4581 prot., datë 19.11.2014 me objekt “Restaurimi i Ndërtesës ku u mbajt Kongresi i Lushnjës”, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera.

10.1 Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë (pa tvsh), nga shoqëria “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4581 prot., datë 19.11.2014 me objekt “Restaurimi i Ndërtesës ku u mbajt Kongresi i Lushnjës”, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera.

Menjëherë

B.2. SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETI EFICENCËS DHE EFEKTIVITETIT

Për shpenzimet të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në buxhetin e Bashkisë, në shumën 61,830,430 lekë, pasi në prokurimin e fondeve publike për punë nuk është zbatuar parimi i 3E-ve Ekonomicitet, Efikasitet dhe Eficencë.

1. Gjetje nga auditimi: Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka mangësi, pasi (1) kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomike më të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderëve. Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të qartë nga ana e Njësisë së Prokurimit, për rrjedhojë lejojnë KVO t’i interpretojë ato në mënyra të ndryshme e subjektive; (2) KVO ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriterëve të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në procedure. Konkretisht, ka s`kualifikuar për mangësi në ofertë për plotësimin e

kritereve të veçanta mangësi këto që lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues OE në kundërshtim me nenin 52, 53/1, 55, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu V pika 4, Kreu IX pika 1/ç, duke mos përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, me impakt financiar në dëm të autoritetit kontraktor, të llogaritur si diferencë ndërmjet ofertës së shpallur fituese dhe ofertës më të ulët të skualifikuar, në 6 procedura prokurimi, në vlerat si më poshtë:

-25,071,852 lekë, në tenderin me objekt “Rikualifikim i sheshit, unifikim fasadash”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Lushnjë, më datë 20.06.2014, me fondin limit 108,592,720 lekë;

-1,121,118 lekë, në tenderin me objekt “Shtesë kati dhe rikonstruksion i objektit: Shkolla 9-vjecare Riza Ibrahimi të fshatit Zhame, Komuna Dushk”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, ish-Komuna Dushk, më datë 02.09.2014, me fondin limit 25,999,552 lekë;

-3,114, 695 lekë, në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare të fshatit Thanasaj”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, ish-Komuna Dushk, më datë 02.09.2014, me fondin limit 13,152,591 lekë;

-236,140 lekë, në tenderin me objekt “Ndërtim lulishte në fshatin Gramsh” të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, ish-Komuna Dushk, më datë 10.06.2014, me fondin limit 3,275,711 lekë

-1,089,346 lekë, në tenderin me objekt “Rehabilitimi i linjes së dergimit të ujesjellesit qendra e banuar Dushk” të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, ish-Komuna Dushk, më datë 01.09.2014, me fondin limit 7,251,372;

-20,617,771 lekë, në tenderin me objekt “Rotondo e Plugut – Postoblloku, rruga e hyrjes Lushnjë-Tiranë” të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Lushnjë, në vitin 2014, me fondin limit 89,800,699 lekë.

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht atyre institucionale në vendimmarrje për caktimin e përbërjes së njësisë së prokurimit, duke përfshirë përveç anëtarëve me formim juridik anëtarë me formim ekonomik e financiar si dhe, në pamundësi objektive, të angazhojë ekspertë të këtyre fushave, me qëllim përcaktimin e kritereve të veçanta dhe specifikimeve teknike në prokurimin e fondeve për punë publike, sa më reale, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, për të garantuar realizimin e kontratave me cilësi duke siguruar në të njëjtën kohë përdorimin me efektivitet dhe dobishmëri të fondeve publike dhe duke shmangur sa më shumë subjektivizmin në vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si dhe të analizohen procedurat sa më sipër dhe të kërkohet që të përzgjidhen për anëtar të KVO kandidatë që plotësojnë kritere të larta profesionale dhe me integritet të plotë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: -Në tenderin me objekt “Shtesë kati dhe rikonstruksion i objektit: Shkolla 9-vjecare Riza Ibrahimi të fshatit Zhame, Komuna Dushk”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, ish-Komuna Dushk, më datë 02.09.2014, me fondin limit 25,999,552 lekë u konstatua se preventivi nuk është bërë konform rregullave dhe çmimeve të përcaktuara në VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, duke bërë që të rritet në mënyrë fiktive fondi limit me efekt negativ financiar në buxhetin e Bashkisë në shumën **1,678,148 lekë**, si rezultat i veprimeve jo në përputhje me nenin 57, Kreu VII, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c dhe neni 20, “Mos diskriminimi”, pasi rritja fiktive e fondit limit ka shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë për të paraqitur oferta më të ulta.

-Në tenderin me objekt “Rehabilitimi i fasadave në qendër të qytetit dhe në Rrugën Misto Mame” të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Lushnjë, të zhvilluar më datë 04.06.2015, me fondin limit 18,079,459 lekë, u konstatua se preventivi i hartuar nuk është bërë konform rregullave dhe çmimeve të përcaktuara në VKM nr. 568, datë 27.06.2013, pasi përshkrimi i punimeve nuk korrespondon me zërin e punimeve përkatëse. Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c dhe neni 20, “Mos diskriminimi”, me pasojë rritje fiktive të fondit limit në shumën prej **8,901,360 lekë**, me efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë pasi n.q.s. do të kishte përputhje të plotë me referencat e manualit të çmimeve të përshkruar më sipër, fondi limit do të ishte 9,932,455.5 lekë, duke zbritur edhe vlerën prej 1,031,095 lekë nga diferenca e ofertës fituese me fondin limit.

2.1 Rekomandim: Të kërkohej në mënyrë institucionale nga Njësia e Prokurimit që përpara se të propozojë për miratim DST, edhe në rastet kur çmimi i kontratës mbështetet në preventiva të përgatitur nga ekspertë të certifikuar jashtë njësisë së prokurimit, të verifikojë përputhshmërinë e çmimeve të preventivit me çmimet e manualit në fuqi, të çmimeve të tregut dhe atyre me bazë analizën e çmimit, me qëllim shmangien e rritjes në mënyrë fiktive të fondit limit dhe sigurimin e mirë përdorimit të fondeve publike.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 141 dhe neni 153 pika 1, 2 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore :

I. “Zgjidhjen e kontratës së punës”, për 7 punonjësit si me poshtë:

- 1. zj. T.K**, me detyrë Nënkryetare e Bashkisë, në cilësinë e Kryetare e KVO.
- 2. zj. M.H**, me detyrë Drejtore e Planifikimit të Territorit, në cilësinë e anëtare e KVO.
- 3. zj. J.B**, me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtar i KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

a-Për tenderin me objekt “Rehabilitimi i fasadave në qendër të qytetit dhe në rrugën Misto Mame”, zhvilluar më 04.06.2015, me fondin limit pa tvsh 18,079,459 lekë, shpallur fitues kompania “██████████” shpk, me vlerën e kontratës me tvsh 20,458,020 lekë (Nuk është shqyrtuar nga KVO oferta më e ulët e pjesëmarrësve në tender, ajo e BO “██████████” shpk dhe “██████████” shpk, me ofertë më të ulët, në shumën prej 11,243,040 lekë, nga operatori i shpallur fitues, oferta e të cilit është në shumën prej 17,048,350 lekë, pa tvsh. Sa më sipër veprimet janë në kundërshtim me nenin 58, Kreu VII, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b- Për tenderin me objekt “Rotondo e Plugut – postblloku, rruga e hyrjes Lushnjë-Tiranë”, zhvilluar në vitin 2014, me fondin limit pa tvsh 89,800,699 lekë, shpallur fitues operatori ekonomik “██████████” shpk, me ofertën 89,645,588 lekë. Në këtë tender, BO “██████████” shpk & “██████████” shpk, me ofertë ekonomike 69,027,817 lekë, është skualifikuar për devijime të parëndësishme dhe pas ankimimit në KPP, ka fituar të drejtën dhe është kualifikuar nga KVO. Pas kualifikimit, operatori “██████████” shpk, i cili pas kualifikimit të BO “██████████”, renditet i dyti për nga oferta e paraqitur, ka drejtuar ankesë Autoritetit Kontraktor, në vend që ta dërgonte tek KPP, me objekt se “██████████” nuk plotëson disa kriterë dhe duhet të skualifikohet. Pas vlerësimit të ankesës, është bërë rivlerësimi i subjekteve dhe BO “██████████” është skualifikuar përsëri, me devijime të parëndësishme në plotësimin e kriterëve të cilat nuk cenojnë thelbin e kontratës për zbatim. Ankesa e operatorit “██████████” shpk nuk e thotë burimin e informacionit për operatorin tjetër pjesëmarrës në tender BO “██████████”, e cila të krijon përshtypjen e një bashkëpunimi të këtij operatori me autoritetin kontraktor, prej nga ku mund të kenë rrjedhur

informacione mbi dokumentacionin e operatorit tjetër pjesëmarrës në tender dhe i renditur i pari BO "██████████". Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 25 e 53.

- 4. **zj. K.H.**, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtares së njësise së prokurimit,
- 5. **zj. M.L.**, ing. Ndërtimi, në cilësinë e anëtares së njësise së prokurimit,
- 6. **zj. B.K.**, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtares së njësise së prokurimit,
- 7. **zj. J.B.**, me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtares së njësise së prokurimit,

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për tenderin me objekt "Ri jetësimi i Shëtitores, Kongresi", zhvilluar më 20.04.2015, me fondin limit pa tvsh 125,000,000 lekë, shpallur fitues operatori ekonomik "██████████" shpk, me vlerën e kontratës me tvsh 150,000,000 lekë. Në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit janë përcaktuar kërkesa në DST, pika 2, licence profesionale të kategorive më të larta në raport me volumet e punës të parashikuara në tender, e cila ka sjellë për pasojë shmangien nga pjesëmarrja në tender të operatorëve të tjerë të cilët disponojnë kategoritë përkatëse të licencave për zërat e punimeve të paraqitura në preventiv. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014 "Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit" dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, gërma c, ç dhe d, dhe neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", gërma a, b dhe c dhe neni 20, "Mosdiskriminimi" si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", Kreu VII, neni 57.

*II. Mbështetur në nenin 141, 153, 201 dhe 202 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe kontratës individuale të punës, nenet 8 dhe 9, Kryetari i Bashkisë Lushnjë, të vlerësoj të metat e mangësitë e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore ose administrative sipas shkallës së përgjegjësisë për punonjësit e atakuar në RP të Auditimit si **L.B, L.M, L.H, I.B, A.C, L.S, A.M, M.N, B.I, E.S, M.B, O.S. A.A, E.D, N.T, N.F, E.V, E.GJ, R.B, P.B, Z.B**, dhe, për punonjësit e tjerë të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit që nuk janë përfshirë më sipër, të analizohet shkalla e përgjegjësisë dhe të reflektohet në vlerësimin vjetor të punës individuale.*

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Nga Bashkia Lushnjë, të merren masa që, në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t'i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Lushnjë, të vendosë **masë administrative** për 2 mbikëqyrës të punimeve dhe 2 Kolaudatorë, **si më poshtë:**

1. Ing. L.V. me gjobë në masën 100,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt "Rehabilitimi i Fasadave në Qendër të Qytetit dhe në Rugën "Misto Mane", Bashkia Lushnjë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësise vendore në vlerën 2,405,963 lekë pa tvsh, për punime të pakryera e të përfituara padrejtësisht nga subjekti (sipërmarrësi) si rezultat i veprimeve në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 "Për Kontrollin dhe Disiplininimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar.

Menjëherë

2. Ing. RR.M, me gjobë në masën 50,000 lekë, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt "Rehabilitimi i Fasadave në Qendër të Qytetit dhe në Rugën "Misto Mane", Bashkia Lushnjë, me pasojë dëm ekonomik

ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën 2,405,963 lekë pa tvsh për punime të pakryera të përfituara padrejtësisht nga subjekti (sipërmarrësi) si rezultat i veprimeve në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

Menjëherë

3. Ing. V.T, me gjobë në masën 100,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Shtrimi i Rugëve Bujqësore me Çakull dhe Rikompozim i Lulishtes Bubullimë”, ish-komuna Bubullimë, Lushnjë, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën 1,551,615 lekë pa tvsh, nga të cilat vlera 1,293,600 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 258,015 lekë si pasojë e dëmeve të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, të përfituara padrejtësisht nga subjekti (sipërmarrësi) si rezultat i veprimeve në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

4. Ing. S.T, me gjobë në masën 50,000 lekë, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Shtrimi i Rugëve Bujqësore me Çakull dhe Ri kompozim i Lulishtes Bubullimë”, ish-komuna Bubullimë, Lushnjë, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën 1,551,615 lekë pa tvsh, nga të cilat vlera 1,293,600 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 258,015 lekë si pasojë e dëmeve të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, të përfituara padrejtësisht nga subjekti (sipërmarrësi) si rezultat i veprimeve në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

Menjëherë

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Lushnjë për:

I. 4 (katër) punonjës të ish-Komunës, Karbunarë.

1. **z. B.N,** ish-Kryetar i Komunës, Karbunarë, në cilësinë ish-titullarit të Autoritetit Kontraktor.
2. **z. N.A,** anëtar i komisionit të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.
3. **z. A.D,** anëtar i komisionit të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.
4. **z. N.S,** anëtar i komisionit të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

II. 6 (gjashtë) punonjës të Bashkisë Lushnjë, nga të cilët 3 anëtarë të KVO dhe 3 anëtarë të njësisë prokurimit publik, si më poshtë:

1. **Zj. T.K,** me detyrë Nënkryetare e Bashkisë, Kryetare e KVO.
 2. **Zj. M.H,** me detyrë Drejtoresh e Planifikimit të Territorit, anëtare e KVO.
 3. **Zj. J.B,** me detyrë ekonomiste, anëtar i KVO dhe anëtare e NJHDT,
 4. **zj. K.H,** me detyrë juriste, anëtare e NJHDT,
 5. **zj. M.L,** ing. Ndërtimi, anëtare e NJHDT,
 6. **zj. B.K,** me detyrë juriste, anëtare e NJHDT,
- pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Shënim: Duke marrë shkas nga ankesa e paraqitur nga punonjësit e administratës të Bashkisë Lushnjë datë 29.07.2016, protokolluar në KLSH me numër 212/154 Prot, datë 01.08.2016, pas paraqitjes dhe rivlerësimit të fakteve të reja, bazuar në Rregulloren e Brendshme të KLSH, me propozim të Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, mbështetur në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa V, kreu I, Akti administrativ seksioni 3- Ligjshmëria, pavlefshmëria dhe korrigjimi i aktit administrativ dhe ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja (gj), Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, anuloi masën e rekomanduar në Rubrikën E, “Kallëzim penal” pika II., të këtij vendimi, duke **e dërguar për vlerësim gjithë dosjen në prokurori.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R